



TEC CONSULT sh.p.k
Rr.Sitki Cico P.12/1
E-mail: teconsult@teconsultalbania.com

I.C.P-04

INFRA CONSULT PROJECT04
Rruga "Nasi Pavlo", Pall. 15/1,
Shk. 3, Ap. 37, Tel/Fax: + 355
42371328
icp04@mod.gov.al

ADRIAN TAFILI

Rruga "Kodra e Diellit", Pll.i ri
Prane kultit "Eleonora,kat.1
Cel: + 355 692102013

❖ HYRJE

Ne kuadrin e investimeve nga Fondi i Zhvillimit te Rajoneve (F.ZH.R.), eshte kerkuar nga Bashkia Lezhe financimi i projektit te ndertimit te Terminalit te Udhetareve.

Vendndodhja e Terminalit, parashikohet ne zonen e Stacionit Hekurudhor te Udhetareve, lokalizuar ne pjesen veriperendimore te qytetit ne distanca te aferta nga qendra e tij.

Siperfaqja e kerkuar per organizimin e vendqendrimit te linjave te autobuzeve interurbane dhe te linjave te furgonave brenda rrethit, rezulton ne rreth 5.200 m² rruge e sheshe dhe rreth 860 m² siperfaqe te brendeshme te Terminalit ekzistues te stacionit hekurudhor i kompozuar nga pjese te ndryshme infrastrukture si :

- rruga hyrese,
- vendqendrim autobuze e furgone,
- vendqendrim dhe vendkalime te udhetareve
- ambiente te terminalit ekzistues

Terminali i ri do te sherbeje per nje organizim te mire te linjave ekzistuese dhe do te ofroje kushte optimale menaxhimi dhe sherbimi.

Sipas kerkeses, linjat operuese interurbane parashikohet te jene gjithsej 9 (nente) ne linjat e meposhteme, ndersa linjat e furgonave per udhetime brenda rrethit parashikohen gjithsej 19 (nentembedhjete).

❖ PERSHKRIMI I GJENDJES EKZISTUESE

➤ Rruga Hyrese

Rruga hyrese per ne stacionin ekzistues hekurudhor, fillon ne rrethrotullimin ne dalje te Ures mbi lumin Drin (hyrja veriore e qytetit) dhe perfundon ne hyrje te sheshit para stacionit hekurudhor, ku mendohet te zhvillohet infrastruktura e re e vendqendrimit te linjave interurbane (nderqytetese) dhe atyre te brendeshme (rrethinave).

Pjesa rrugore qe do te trajtohet, zhvillohet nga vendqendrimi aktual i linjave te brendeshme (furgona e autobuze) deri ne hyrje te sheshit qe do te projektohet me karakteristikat e meposhteme geometrike:

- Gjatesia e pergjitheshme L=100 m
- Gjeresia e gjurmes kaluese b=5.0 m
- Kuneta betoni me gjeresi 2x0.5 m
- Bordura te parapergatitura betoni ne te dy anet 15x30 cm



TEC CONSULT sh.p.k
Rr.Sitki Cico P.12/1
E-mail: teconsult@teconsultalbania.com

I.C.P-04

INFRA CONSULT PROJECT04
Rruga "Nasi Pavlo", Pall. 15/1,
Shk. 3, Ap. 37, Tel/Fax: + 355
42371328
icp04@mod.gov.al

ADRIAN TAFILI

Rruga "Kodra e Diellit", Pll.i ri
Prane kultit "Eleonora,kat.1
Cel: + 355 692102013

Gjendja e shtresave rrugore eshte si me poshte:

Segmenti rrugor eshte rehabilituar kohet e fundit. Nga sa mund te evidentohet ekzistojne shtresat e meposhteme te asfaltuara:

- Shtrese mbajtese asfaltike binderi me trashesi $t=4-5$ cm

Brenda zones se rruges, ne anen e majte te saj, ekzistojne ndertime 1 kat (barake) njera prej te cilave e vendosur pothuaj mbi kunete.

Parametrat ekzistues gjeometrike te rruges nuk mundesojne shkembimin e dy autobuzeve dhe lejojne vetem shkembimin e autoveturave. Parkimet anesore veshtiresojne akoma me shume kete proces.

Mungojne plotesisht trotuaret, si dhe sinjalistika.



➤ **Sheshi para Stacionit Hekurudhor**

Sheshi para stacionit hekurudhor, paraqitet ne forme te crregullt gjeometrike. Mungojne plotesisht shtresat dhe ka depozitime te mbetjeve urbane dhe materialeve mbeturine ndertimi.

Mungon plotesisht rrjeti i kanalizimeve te ujrave te shiut si dhe ai i kanalizimit te ujrave te zeza.

Ne shesh ekzistojne shtylla ankerore prej betoni centrifugal, qe realizojne shperndarjen e transmetimin e rrjeteve elektrike 10kv dhe 6kv sipas destinacioneve si dhe shtylla centrifugale te tensionit te ulet.

Po keshtu, si pasoje e zhvillimeve kaotike te pas viteve `90, ekzistojne mure rrethues me lartesi rreth 2.0 m dhe ndertime (dyqan), qe hyjne ne zonen e parashikuar per



TEC CONSULT sh.p.k
Rr.Sitki Cico P.12/1
E-mail: tecconsult@tecconsultalbania.com

I.C.P-04

INFRA CONSULT PROJECT04
Rruga "Nasi Pavlo", Pall. 15/1,
Shk. 3, Ap. 37, Tel/Fax: + 355
42371328
icp04@mod.gov.al

ADRIAN TAFILI

Rruga "Kodra e Diellit", Pll.i ri
Prane kultit "Eleonora,kat.1
Cel: + 355 692102013

ndertim dhe veshtiresojne qarkullimin e mjeteve sidoqe numri i tyre aktual rezulton i kufizuar.

Mungojne plotesisht elemente te akomodimit urban, sic jane trotuare, ndricim, gjelberim, etj., qe veshtiresojne me tej qarkullimin pedonal.



➤ Terminali Hekurudhor

Terminali i udhetareve te Stacionit Hekurudhor Lezhe, paraqitet ne formen e nje ndertese me lartesi 2 kt me siperfaqe te pergjitheshme rreth 860 m² . Pergjithesisht, struktura ekzistuese paraqitet ne gjendje te mire konstruktive. Verehet amortizim i madh e per pasoje demtime te theksuara te fasades, taraces dhe sidomos te ambienteve te sherbimit, ne menyre te vecante te banjove qe aktualisht jane jashte sherbimi. Kjo gjendje ka ardhur si pasoje e mungeses se plote te punimeve te mirembajtjes dhe investimeve.



Salla e madhe e pritjes dhe qendrimit te udhetareve, ne pergjithesi paraqitet ne gjendje te mire, por me nevoja te nderhyrjes per rehabilitim dhe pershtatje.



TEC CONSULT sh.p.k
Rr.Sitki Cico P.12/1
E-mail: teconsult@teconsultalbania.com

I.C.P-04

INFRA CONSULT PROJECT04
Rruga "Nasi Pavlo", Pall. 15/1,
Shk. 3, Ap. 37, Tel/Fax: + 355
42371328
icp04@mod.gov.al

ADRIAN TAFILI

Rruga "Kodra e Diellit", Pll.i ri
Prane kultit "Eleonora,kat.1
Cel: + 355 692102013

Ekzistojne gjithashtu ambiente te lokalizuara sherbimi te stafit (zyra), gjendja e te cilave paraqitet relativisht e qendrueshme.

Mungon plotesisht arredimi i salles se udhetareve, kryesisht stola, si dhe cdo lloj tjeter arredimi qe ndihmon ne qendrimin apo informimin e udhetareve.

Mungon plotesisht sistemi i kondicionimit dhe eshte me mangesi te theksuara sistemi i ndricimit.